REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2021:202842
Datë: 09.11.2023
Numri i dokumentit: 04897964

PS.nr.54/23

GJYKATA THEMELORE–DEPARTAMENTI SPECIAL NË PRISHTINË, në përbërje nga gjyqtarët Violeta Namani-Hajra, si kryetare e trupit gjykues, Suzana Çerkini dhe Vesel Ismaili, anëtarë të trupit gjykues, në çështjen penale kundër të pandehurës J.B. për shkak të veprën penale Pjesëmarrja ose organizimi i grupit kriminal të organizuar nga neni 283 par. 1 të KPRK-së, lidhur me veprën penale Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 paragrafi 1 të KPPRK-së, e akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, PPS. nr.12/2016, të datës 13 Shtator 2021, gjykata jashtë seancës, me datë **06.11.2023,** mori këtë:

A K T V E N D I M

H U D H E T pjesërisht aktakuza e Prokurorisë Speciale e Republikës së Kosovës, PPS. nr.12/2016, të datës 13 Shtator 2021, ashtu që:

P U SH O H E T procedura penale, kundër të pandehurës J.B., nga i ati J. dhe e ëma L., e gjinisë P., e lindur më .... në M., me vendbanim në L., rruga "N.", pn, me numër personal ...., Serbe, shtetase e Republikës së Kosovës**, për shkak të vdekjes.**

Shpenzimet e procedurës penale mbesin në barrë të mjeteve buxhetore të kësaj gjykate.

A r s y e t i m

Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës, ka paraqitur aktakuzë PPS. nr.12/2016, të datës 13 Shtator 2021, kundër të pandehurve D. J. ka kryer veprën penale Pjesëmarrja ose organizimi i grupit kriminal të organizuar nga neni 283 par. 2 të KPRK-së, lidhur me veprën penale Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 paragrafi 1 të KPRK-së, të pandehurit H. B., A. A., A. K., Ç. T., B. B., M. I., I. K., B. M. dhe J.B. kanë kryer veprën penale Pjesëmarrja ose organizimi i grupit kriminal të organizuar nga neni 283 par. 1 të KPRK-së, lidhur me veprën penale Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 paragrafi 1 të KPRK, të pandehurit X. F., H. H., M. H., M. R. dhe N. M. kanë kryer veprën penale Pjesëmarrja ose organizimi i grupit kriminal të organizuar nga neni 283 par. 1 të KPRK-së, lidhur me veprën

2023:237655

penale Keqpërdorimi i autorizimeve ekonomike nga neni 290 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 nënparagrafi 1.5 të KPRK-së.

Gjykata lidhur me këtë çështje penale ka caktuar shqyrtimin gjyqësor me datë 16.10.2023, ku nuk ka prezantuar mbrojtësi i të pandehurës J.B. av. Shyqyri Syla, i njëjtit përmes emali zyrtare e ka njoftuar gjykatës se J.B. ka ndërruar jetë me datë 08.09.2023, ku si provë ka ofruar dëshminë e vdekjes, gjë që vërtetohet edhe nga certifikata e vdekjes, e lëshuar nga Zyra e Ministrisë së Punëve të Brendshme të Komunës së L., me numër reference 12/2023RV/12002/Sp, me nr. rendor 12, të lëshuar me datën 26/10/2023, nga e cila konstatohet se J.B., me të dhënat si në dispozitiv të këtij aktvendimi, ka vdekur me datë 08/09/2023, në K..

Vendimi lidhur me kompensimin e shpenzimeve procedurale dhe paushallit është marrë në bazë të nenit 453 par.1 të KPPK-së.

Nga të dhënat e paraqitura më lartë gjykata konstaton se në rastin konkret janë plotësuar kushtet ligjore që kundër të pandehurës të hedhet aktakuza dhe të pushohet procedura penale, prandaj në pajtim me nenin 357 par.1 pika 1.3 KPPRK-se, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
Departamenti Special
PS.nr. 54/23, datë 06.11.2023

Zyrtare Ligjore
Rilinda Kadriu

Kryetarja e trupit gjykues– gjyqtarja
Violeta Namani-Hajra

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktvendimi lejohet ankesa dhe mund të ushtrohet nga palët e autorizuara brenda pesë (5) ditëve, nga dita e pranimit, përmes kësaj gjykate, duke ju drejtuar Gjykatës së Apelit në Prishtinë.

2023:237655